

VENDIM
Nr. 307, datë 16.4.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË
ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR**

(Ndryshuar me VKM nr. 337, datë 23.4.2020; nr. 375, datë 6.5.2020; nr. 761, datë 23.9.2020; nr. 937, datë 25.11.2020; nr. 1133, datë 24.12.2020; nr. 128, datë 3.3.2021; nr. 425, datë 8.7.2021; nr. 481, datë 30.7.2021; nr. 591, datë 13.10.2021; nr. 853, datë 29.12.2021; nr. 182, datë 30.3.2022; nr. 802, datë 12.12.2022; nr. 280, datë 4.5.2023; nr. 683, datë 6.12.2023; nr. 340, datë 5.6.2024; nr. 756, datë 19.12.2025; nr. 483, datë 26.6.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të nenit 16, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 13 180 466 653 (trembëdhjetë miliardë e njëqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Tiranë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’u kalojë njësisë zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në masën 4 770 482 221 (katër miliardë e shtatëqind e shtatëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë, në masën 8 409 984 432 (tetë miliardë e katërqind e nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.

3. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë në masën 1 863 461 542 (një miliard e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi në masën 1 363 461 542 (një miliard e treqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të

rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.

3.1 Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 1 931 788 178 (një miliard e nëntëqind e tridhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 1 277 622 177 (një miliard e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 654 166 001 (gjashtëqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e një) lekësh, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.

Efekti financiar shtesë do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit të projekteve me ecuri të ngadaltë.

3.2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2022, të jetë në masën 1 265 498 838 (një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, i cili i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

3.3 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 387 370 974 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3.4. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2023, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë pa TVSH, i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin ‘Shpenzime kapitale me financim të brendshëm’, të programit 06210 “Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë’.

3.5 Përveç përcaktimeve të pikës 3.4 të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit të 2023, do të jetë në masën 528 451 028 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e njëzet e tetë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 305 255 685 (treqind e pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë;

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi prej 223 195 343 (dyqind e njëzet e tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e tre) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të

rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim në Bashkinë Tiranë.

3.6. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2024, do të jetë në masën 495 066 760.71 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë presje shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 332 281 401,71 (treqind e tridhjetë e dy milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e një presje shtatëdhjetë e një) lekësh pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë;

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi prej 162 785 359 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.

3.7. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2025, në masën 864 086 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2025, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

3.8. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2026, në masën 17 720 185 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i cili i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2026, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi” për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama